

 Menu

HOME > NEWS

Njoftim për Shtyp datë 02 Maj 2024

2 May, 2024 by **KLJGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, në datë 02.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli vendosi të shtyjë seancën dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...} dhe të caktojë seancën e radhës më datë 16.05.2024.

Më tej, Këshilli miratoi raportin për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...} për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022.

Pas shqyrtimit të projektaktit, Këshilli vendosi për refuzimin e kërkesës së z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Këshilli miratoi vendimet për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për:

- 1 (një) pozicion i lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, në fushën e të drejtës civile;
- 4 (katër) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, konkretisht 3 (tre) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 3 (tre) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konkretisht 2 (dy) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe 1 (një) pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 1 (një) pozicion i lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, në fushën e të drejtës civile;
- 2 (dy) pozicione të lira në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në vijim, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për 3 (tre) pozicione të lira në fushën e të drejtës civile.

Gjithashtu, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 (një) pozicion të lirë.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, duke caktuar znj. Mevlute Çausi, gjyqtare për median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 07.02.2024, 07.02.2024 (ora 15:30), 15.02.2024, 20.02.2024, 23.02.2024 dhe 29.02.2024.

Për shkak të mungesës së kuorumit, Këshilli vendosi të shtyjë shqyrtimin e projektvendimeve:

- “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë””;
- “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. {...} nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019””.

Në përfundim, Këshilli vendosi caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes së veçantë, në gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.